



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:268940

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05545764

C.nr. 888/2023

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin Artan Abazi dhe bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, në çështjen juridike kontestuese të paditëses S.A. nga ....., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Enver Ajvazi, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti padi për kompensimin e shpërblimit jubilar, me vlerë të kontestit në shumën monetare prej 315.75 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 01.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses S. A. nga ..... dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Kamenicës – Drejtoria e Arsimit, që në emër të pagesës për shpërblim jubilar, për 20 vite përvojë pune, në vlerë të 75 % të një page bazë, t'ia paguajë shumën prej 315.75 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 22.11.2023, (si datë e paraqitjes së padisë në gjykatë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbartimit ligjor.

**II. DETYROHET** e paditura, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumën prej 98.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbartimit ligjor.

**A r s y e t i m**

Paditësja përmes përfaqësueses së saj me autorizim, në këtë gjykatë më datë 22.11.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shpërblimin jubilar. Në përmbajtjen e padisë i njëjti ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura. Më tej ka shtuar se paditësi fillimisht i është drejtuar të paditurës – Komunës së Kamenicës- DKA-së, ku ka kërkuar kompensimin e shpërblimit jubilar, mirëpo të njëjtit nuk janë përgjigjur. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës të aprovuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi, ka theksuar se nuk e konteston faktin se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, por që, e kundërshton faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit, me nr. të protokollit 2056, e datës 18.04.2017, nuk është e regjistruar në faqe të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale siç edhe kërkohet me Udhëzimin Administrativ me nr. 12/2011 për Regjistrimin e Marrëveshjeve Kolektive. Tutje ka shtuar se e paditura në asnjë moment nuk ka marrë për obligim anën financiare për përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kjo Kontratë Kolektive, dhe si rrjedhojë i mungon legjitimiteti real pasiv, duke theksuar edhe faktin se buxheti komunal përbëhet prej të hyrave vetanake, granteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe donacioneve të tjera, ashtu që, e paditura, në asnjë moment nuk e ka për obligim përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë.

Gjykata ka vlerësuar parashkrimin e kërkesës bazuar në kundërshtimin e të paditurës, por ka gjetur se periudha kohore e kërkuar për këtë kompensim nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 22.11.2023, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditësit është e themeltë.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura i ka pohuar faktet vendimtare, pra gjendjen faktike, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara konform nenit 398 të LPK-së.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “*kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 21.01.2021, konkretisht nenin 35 paragrafi 7 të kësaj Kontrate, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi. Kërkesat e paditëses bazën ligjore e ka në nenin 35, par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit.

Bazuar në nenin 35, paragrafi 8, pika 8.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, që përcakton se *“Punëtorët, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë të 75 % një page bazë për 20 vjet përvojë të punës”*, andaj nga të cekurat e miratoi kërkesëpadinë e paditësit dhe e detyroi të paditurën që në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune, t’ia paguajë paditësit shumën monetare prej 315.75 euro.

Me Ligjin e Punës nr.03-L/212 parashihet se sa i përket çështjeve të punëdhënësit me punëmarrësin ata të drejtat dhe detyrimet e tyre mund t’i rregullojnë edhe me Kontratë Kolektive dhe Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me Ligj të punës, pra të drejtat e punëmarrësit me Kontratën Kolektive mund të avancohen më lartë se të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Sa i përket pretendimit të palës së paditur se kërkesa e paditësit është përfshirë në parashkrim, një pretendim të tillë gjykata nuk e mori për bazë për faktin se kërkesa e paditësit është brenda periudhës kohore në të cilën Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe 21.01.2021 ka qenë në fuqi, përkatësisht deri në periudhën kohore para shkëputjes së Kontratës Kolektive të Arsimit në mënyrë të njëanshme nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, e po ashtu edhe në përputhje me mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës për vlefshmërinë e Kontratave, andaj edhe kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor prej 3 viteve dhe rrjedhimisht kërkesëpadia e paditësit nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç ka pretenduar e paditura.

Gjykata po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditësit edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/*Kontrata nr.24. e datës 18.04.2017*, dhe 21.01.2021 pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komonat apo DKA-të.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ Ligji nr. 04/L-077 datë 19.06.2012.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë**  
**Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil**  
**C.nr.888/2023, më datë 01.03.2023**

**Gjyqtari,**  
**Artan Abazi**

Numri i lëndës: 2023:268940  
Datë: 04.04.2024  
Numri i dokumentit: 05545764

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimin pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.